<p>Neni 95 Rivlerësimi i sendeve të sekuestruara</p> <p>1. Secila palë ka të drejtë që brenda afatit prej 3 ditësh, nga dita e vlerësimit të bërë të sendeve të sekuestruara, që t'i propozojë autoritetit permbarues caktim të vlerës më të vogël apo më të madhe të sendeve të sekuestruara nga ajo e caktuar më parë, apo caktim të vlerësimit të ri. Një gjë e tillë nuk lejohet po që se vlersimin e pare e ka bërë eksperti.</p> <p>2. Për propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni, autoriteti permbarues vendosë me anë të konkluzionit.</p>	<p>Član 95 Ponovno procenjivanje zaplenjenih stvari</p> <p>1. Svaka strana ima pravo da u roku od 3 dana, od dana izvršene procene zaplenjenih stvari, predlaže izvršnom organu određivanje manje ili veće vrednosti zaplenjenih stvari od prethodno određene, ili određivanje nove procene. Tako nešto nije dozvoljeno ako je prvu procenu učinio veštak.</p> <p>2. O predlogu iz stava 1. ovog člana, izvršni organ odlučuje zaključkom.</p>	<p>Article 95 Reevaluation of the sequestered items</p> <p>1. Each party has the right within 3 from the day of conducted evaluation of the sequestered items, to propose to the enforcement authority the lowest or highest value of sequestered items from the one determined before, or determination of new evaluation. This shall not be permitted if the first evaluation has been conducted by the expert.</p> <p>2. Over the proposal from paragraph 1 of this article, the enforcement authority shall decidethrough a conclusion.</p>
<p>Neni 96 Procesverbali për regjistrimin dhe vlerësimin</p> <p>1. Për regjistrimin dhe vlerësimin sekuestrues gjykata përpilon procesverbal.</p> <p>2. Në procesverbal veç e veç tregohen sendet e sekuestruara dhe vlera e tyre e caktuar, si dhe shënohen deklaratat e palëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë të procedurës, e edhe ato të personave të tretë për ekzistimin eventual të të drejtave të</p>	<p>Član 96 Zapisnik o registraciji i procenjivanju</p> <p>1. O plenidbinoj registraciji i procenjivanju sud sačinjava zapisnik.</p> <p>2. U zapisniku se ponaosob prikazuju zaplenjene stvari i njihova određena vrednost, a takođe se prikazuju izjave stranaka i drugih učesnika u postupku, pa i trećih lica o eventualnom postojanju njihovih prava koja mogu sprečiti izvršenje</p>	<p>Article 96 Record on registration and evaluation</p> <p>1. For registration and evaluation of sequestrated items, the enforcement authority shall draft the record.</p> <p>2. The record indicates separately the sequestered items and their determined value, and notes the statements of the parties and other participants in the procedure, but also of third persons for eventual existence of their rights which may obstruct the enforcement of the</p>

<p>tyre që mund ta pengojnë përmbarimin për sendet e sekuestruara.</p> <p>3. Në sendet e sekuestruara vihet shenja e caktuar nga e cila shihet se janë të sekuestruara.</p> <p>4. Kreditori i përmbarimit ka të drejtë që ne procesverbalin e autoritetit përmbarues të përpiluar me rastin e sekuestrimit të sendeve të debitorit ta publikojë në mjetet e informimit publik.</p> <p>Neni 97 Shënimi në procesverbal i të dhënave nga përmbarimi tjetër</p> <p>Në qoftë se pas sekuestrimit të bërë caktohet përmbarimi tjetër për sendet e sekuestruara me qëllim të realizimit të kërkesës tjetër të të njëjtit kreditor të përmbarimit, apo të kërkesës së kreditorit tjetër të përmbarimit, nuk do të bëhet regjistrimi dhe vlerësimi i serishëm i sendeve të sekuestruara, veçse në vazhdimin e procesverbalit do të bëhet vetëm shënimi i të dhënave nga aktvendimi i mëvonshëm për përmbarimin.</p> <p>Neni 98 Koha e shitjes së sendeve të sekuestruara</p>	<p>o zaplenjenim stvarima.</p> <p>3. Na zaplenjenim stvarima stavlja se određena oznaka iz koje se vidi da su zaplenjene.</p> <p>4. Izvršni poverilac ima pravo da zapisnik izvršnog organa, sačinjen prilikom zaplenjivanja dužnikovih stvari, objavljuje u sredstvima javnog informisanja.</p> <p>Član 97 Unošenje u zapisnik podataka iz drugog izvršenja</p> <p>Ako se nakon izvršenog zaplenjivanja određuje drugo izvršenje za zaplenjene stvari u cilju realizacije drugog potraživanja istog izvršnog poverioca, ili potraživanja drugog izvršnog poverioca, neće se vršiti popis i ponovno vrednovanje zaplenjenih stvari, samo će se u nastavku zapisnika naznačiti podaci iz naknadnog rešenja o izvršenju.</p> <p>Član 98 Vreme prodaje zaplenjenih stvari</p>	<p>sequestered items.</p> <p>3. A certain mark shall be placed on sequestered items indicating the sequestration.</p> <p>4. Enforcement creditor is entitled to publish the enforcement authority record on sequestration of debtor's items, in the public information means.</p> <p>Article 97 Noting the data from another enforcement in the record</p> <p>If another enforcement is assigned after the conducted sequestration over the sequestered items for the purpose of settling another claim of the same enforcement creditor, or claim of other enforcement creditor, no registration or repeated evaluation of the sequestered items will be done, but further in the record the data from the latter decision for enforcement will be noted.</p> <p>Article 98 Time of sale of sequestered items</p>
--	--	--

<p>1. Shitja e sendeve të sekuestruara kryhet jo më herët se 15 ditë dhe jo më vonë se 30 ditë nga data e sekuestrimit..</p> <p>2. Shitja mund të bëhet edhe para skadimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni po qe se debitori propozon, apo pajtohet me propozimin e kreditorit që shitja e sendeve të sekuestruara të bëhet më herët.</p> <p>3. Shitja e sendeve të sekuestruara mund të bëhet para skadimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, po qe se sendet e këtilla prishen shpejtë, apo kur ekziston mundësia që të bie dukshëm çmimi i tyre pas një kohe të shkurtër.</p> <p>4. Në qoftë se kreditori i përmbarimit jep garancinë për dëmin eventual që do të duhej kompensuar debitorit në rast të anulimit të aktvendimit për përmbarimin, shitja e sendeve të sekuestruara mund të bëhet edhe para skadimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni.</p> <p>Neni 99 Mënyra e shitjes së sendeve të sekuestruara</p>	<p>1. Prodaja zaplenjenih stvari vrši se ne ranije od 15 dana i ne kasnije od 30 dana od dana zaplenjivanja.</p> <p>2. Prodaja se može obaviti i pre isteka roka iz stava 1. ovog člana, ako dužnik predlaže, ili se slaže sa predlogom poverioca da se prodaja zaplenjenih stvari vrši ranije.</p> <p>3. Prodaja zaplenjenih stvari se može obaviti pre isteka roka iz stava 1. ovog člana, ako se takve stvari brzo kvare, ili kada postoji mogućnost da vidno opada njihova cena za kratko vreme.</p> <p>4. Ako izvršni poverilac daje garanciju o eventualnoj šteti koju bi trebalo nadoknaditi dužniku u slučaju poništenja rešenja o izvršenju, prodaja zaplenjenih stvari se može učiniti i pre isteka roka iz stava 1. ovog člana.</p> <p>Član 99 Način prodaje zaplenjenih stvari</p>	<p>1. The sale of the sequestrated items shall be conducted not earlier than 15 days, and not later than 30 days, from the date of sequestration.</p> <p>2. The sale may be conducted also after the expiration of the deadline from paragraph 1 of this article if debtor proposes so, or if he agrees with the creditor's proposal that the sale of the sequestrated items be conducted earlier.</p> <p>3. The sale of the sequestrated items may be done before the expiration of the deadline from the paragraph 1 of this article, if such items have short shelf life, or when there is a possibility of obvious diminishing their price after a short time.</p> <p>4. If the enforcement creditor guarantees for eventual damage which should be compensated to debtor in case of annulment of the enforcement decision, the sale of the sequestrated items may also be conducted before the expiration of deadline from paragraph 1 of this article.</p> <p>Article 99 The method of sale of the sequestrated items</p>
---	--	---

<p>1. Shitja e sendeve të sekuestruara bëhet me anë të ankandit verbal publik ose me ujdinë e drejtpërdrejtë midis blerësit, nga njëra anë dhe autoritetit permbarues, apo subjektit tjetër të autorizuar, nga ana tjetër.</p> <p>2. Mënyra e shitjes së sendeve caktohet me anë të konkluzionit të gjykatës, duke pasur parasysh faktin që të arrihet çmimi më i volitshëm për debitorin.</p> <p>3. Ankandin publik të shitjes e administron autoriteti permbarues, apo personi tjetër i caktuar nga autoriteti permbarues.</p> <p>4. Shitja me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë bëhet midis blerësit, nga njëra anë dhe autoritetit permbarues, apo personit që kryen veprime komisioni, nga ana tjetër. Autoriteti permbarues sendet e sekuestruara i shet në emër dhe llogari të debitorit, kurse personi që merret me veprime komisioni, në emër të vet, por për llogari të debitorit ekzekutiv.</p> <p>5. Shitja me anë të ankandit do të caktohet në qoftë se është fjala për sendet e sekuestruara që kanë vlerë të madhe, ndërkaj mund të pritet se ato do të shiten</p>	<p>1. Prodaja zaplenjenih stvari vrši se putem javne verbalne aukcije ili neposrednim dogovorom između kupca, s jedne strane i izvršnog orana, ili drugog ovlašćenog subjekta, sa druge strane.</p> <p>2. Način prodaje stvari određuje se zaključkom suda, imajući u vidu činjenicu da se postigne najpovoljnija cena za dužnika.</p> <p>3. Javnu aukciju prodaje administrira izvršni organ, ili druga osoba određena od izvršnog organa.</p> <p>4. Prodaja putem neposrednog dogovora vrši se između kupca, sa jedne strane i izvršnog organa, ili osobe koja obavlja radnje komisije, sa druge strane. Izvršni organ prodaje zaplenjene stvari u ime i račun dužnika, dok osoba koja se bavi komisijskim radnjama, u svoje ime, ali na račun izvršnog dužnika.</p> <p>5. Prodaja putem aukcije će se odrediti ako se radi o zaplenjenim stvarima čija je vrednost velika, a može se očekivati da će se iste prodavati po većoj ceni od</p>	<p>1. The sale of sequestrated items shall be done through the verbal public auction, or through direct settlement between the purchaser, in one side and the enforcement authority, or other authorized subject in other side.</p> <p>2. The mode of sale of items shall be determined through enforcement authority conclusion, bearing in mind the goal to achieve the most suitable price for the debtor.</p> <p>3. Public auction shall be administered by the enforcement authority or other person assigned by the enforcement authority.</p> <p>4. Sale through direct settlement shall be conducted between the purchaser, in one side and the enforcement authority, or the person who conducts commission actions, in the other side. The enforcement authority shall sell the sequestered items in behalf of and for the account of the debtor, while the person who deals with commission actions, acts in his behalf but for account of execution debtor.</p> <p>5. Sale through auction will be assigned if it concerns about sequestered items of high value, and it may be expected that these may be sold in higher price than the</p>
--	--	--

<p>sipas çmimit më të lartë nga sa është shuma e vlerësuar.</p> <p>6. Shitja e sendeve do të publikohet në tabelën e shpalljeve të autoritetit permbarues së paku 15 ditë para se të mbahet seanca për shitjen e tyre. Publikimi i shitjes mund të bëhet edhe në mënyrën e paraparë për publikimin e shitjes së sendeve të paluajtshme. Pala mund të përcaktojë se, përveç këtyre mjeteve të shpalljes së shitjes publike, mund të përdoren mjetet tjera të shpalljes, në shpenzim të asaj pale, dhe autoriteti permbarues do të ndihmojnë që shpallja të bëhet edhe me këto mjete shtesë.</p> <p>7. Kreditori i përmbarrimit dhe debitori ekzekutiv do të informohen për vendin, ditën dhe orën e shitjes së sendeve të sekuestruara.</p>	<p>procenjenog iznosa.</p> <p>6. Prodaja stvari će se oglašavati na oglasnoj tabli izvršnog organa najmanje 15 dana pre održavanja ročišta za njihovu prodaju. Oglašavanje prodaje može se učiniti i na način predviđen za oglašavanje prodaje nepokretnih stvari. Stranka može utvrditi da se, osim ovih sredstava oglašavanja javne prodaje, mogu upotrebiti i druga sredstva oglašavanja, o trošku te stranke i izvršni organ će pomoći da se oglašavanje obavlja i ovim dopunskim sredstvima.</p> <p>7. Izvršni poverilac i izvršni dužnik će se informisati o mestu, danu i času prodaje zaplenjenih stvari.</p>	<p>evaluated value.</p> <p>6. Sale of items will be published in notification table of the enforcement authority at least 15 days before the holding of session for their sale. Publication of sale may be done also in a manner foreseen for publication of sale of immovable items. A party may determine that, in addition to these means of announcing the sale to the public, other means of announcement may be employed, at the expense of that party, and the enforcement authority shall facilitate these additional means of announcing the sale.</p> <p>7. Enforcement creditor and enforcement debtor shall be informed about the place, day and hour of the sale of sequestered items.</p>
<p>Neni 100 Seanca e parë e shitjes publike</p> <p>1. Sendet e sekuestruara mund të shiten në ankandin e parë me çmim më të vogël se ai i caktuar, por jo me çmimin më të vogël se 80% e vleres së caktuar me rastin e regjistrimit dhe vlerësimit të sendeve të luajtshme të debitorit, respektivisht në afatin që e ka caktuar autoriteti permbarues</p>	<p>Član 100 Prvo ročište javne prodaje</p> <p>1. Zaplenjene stvari se mogu prodavati u prvoj aukciji po manjoj ceni od određene, ali ne po nižoj ceni od 80% određene vrednosti povodom popisa i vrednovanja pokretnih stvari dužnika, odnosno u roku kojeg je odredio izvršni organ za njihovu prodaju putem neposrednog dogovora.</p>	<p>Article 100 First session of public sale</p> <p>1. Sequestered items can be sold in first auction at a lower price that the one assigned, but not at a price lower than 80% of the value assigned during the registration and evaluation of movable items of the debtor, respectively in the deadline assigned by the enforcement</p>

<p>për shitjen e tyre me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë.</p> <p>2. Ankandi i parë mbahet brenda 30 ditëve nga data e sekuestrimit.</p> <p>3. Nëse sendet e sekuestruara nuk shiten me çmimin minimal të lejuar nga paragrafi 1 i këtij neni, autoriteti permbarues konstaton dështimin e shitjes dhe fton kreditorin që të propozojë ankandin e dytë brenda 15 ditëve.</p> <p>Neni 101 Seanca e dytë e shitjes publike</p> <p>1. Me propozimin nga palët, autoriteti permbarues e cakton ankandin e ri në të cilin sendet e sekuestruara mund të shiten me çmim jo më të vogël se sa 50% e çmimit të përcaktuar gjatë vlerësimit të tyre.</p> <p>2. Propozimin për ankandin tjetër, ose për shitjen me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë, pala mund ta paraqesë brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e ankandit të parë, respektivisht nga dita e skadimit të afatit të caktuar nga autoriteti permbarues për shitje me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë. Ankandi i dytë mbahet brenda 30 ditëve të propozimit për ankandin e dytë.</p>	<p>2. Prva aukcija održava se u roku od 30 dana od dana zaplenjivanja.</p> <p>3. Ako se zaplenjene stvari ne prodaju po minimalno odobrenoј ceni iz stava 1. ovog člana, izvršni organ konstatuje neuspeh prodaje i poziva poverioca da predlaže drugu aukciju u roku od 15 dana.</p> <p>Član 101 Druga ročište javne prodaje</p> <p>1. Predlogom stranaka, izvršni organ određuje novu aukciju u kojoj se zaplenjene stvari mogu prodati po ceni ne nižoj od 50% utvrđene cene tokom njihove procene.</p> <p>2. Predlog za drugu aukciju, ili za prodaju putem neposrednog dogovora, stranka može podneti u roku od 15 dana, od dana prve aukcije, odnosno od dana isteka roka određenog od izvršnog organa za prodaju putem neposrednog dogovora. Druga aukcija održava se u roku od 30 dana od predloga za drugu aukciju.</p>	<p>authority for their sale through direct settlement.</p> <p>2. The first auction shall be organized within 30 days from the date of sequestration.</p> <p>3. If the sequestered items are not sold at this minimum price allowed from paragraph 1 of this article, the enforcement authority shall announce the failure of the auction and shall invite the creditor to propose the second auction within 15 days.</p> <p>Article 101 Second session of public sale</p> <p>1. Upon proposal of the party, the enforcement authority shall assign new auction in which the sequestered item may be sold at a price no less than 50% of the price set during the evaluation.</p> <p>2. The party may present the proposal for another auction, or for the sale through direct settlement, within 15 days from the day of first auction, respectively from the day when the deadline assigned by the enforcement authority for sale through direct settlement elapses. The second auction shall take place within 30 days since the proposal for second auction.</p>
---	--	---

<p>3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe kur sendet e sekuestruara nuk kanë mundur të shiten në vlerën e çmuar me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë në afatin e caktuar nga autoriteti permbarues.</p> <p>4. Në qoftë se pasuritë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk shiten brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e ofertës së parë për shitje apo në rast të tentimit të pasuksesshëm për shitje nga paragrafi 2, atëherë kreditori i përmbarimit mund të kërkojë dorëzimin e sendeve në pronësi të tij, për mbulim të pjesshëm apo të plotë të kredisë në çmim të vlerësuar të atyre sendeve.</p> <p>5. Dispozitat e lartepërmendura të këtij neni do të aplikohen përshtatshmerisht edhe për shitjen e sendeve të sekuestruara përmes marrëveshjes së drejtpërdrejte.</p>	<p>3. Odredbe stava 1. ovog člana shodno se primenjuju i kada se zaplenjene stvari nisu mogle prodati po procenjenoj vrednosti putem neposrednog dogovora u roku određenom od izvršnog organa.</p> <p>4. Ako se imovina iz stava 1. ovog člana ne prodaje u roku od 60 dana od dana prve ponude za prodaju ili u slučaju neuspešnog pokušaja za prodaju iz stava 2, u tom slučaju izvršni poverilac može da traži predaju stvari u njegovom vlasništvu, za delimično ili potpuno namirenje potraživanja po procenjenoj ceni tih stvari.</p> <p>5. Gore navedene odredbe ovog člana shodno će se primenjivati i za prodaju zaplenjenih stvari preko neposrednog dogovora.</p>	<p>3. Provision from paragraph 1 of this article shall also apply if sequestered items could not be sold in the price as evaluated through direct settlement within the deadline assigned by the enforcement authority.</p> <p>4. If the assets from paragraph 1 of this article are not sold within 60 days since the day of first auction or in case of unsuccessful attempt to sell from paragraph 2, the enforcement creditor may request the transfer of items to his ownership, for partial or full recovery of the credit with the evaluated price of those items.</p> <p>5. Above provisions of this article are accordingly applied also for the sale of sequestered items through direct settlement.</p>
<p>Neni 102 Pezullimi i procedurës</p> <p>1. Autoriteti permbarues e pezullon përmbarimin në qoftë se asnjëra nga palët nuk paraqet propozim për ankandin e dytë, apo për shitjen me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë, sipas nenit 109.2 respektivisht nëse kreditori nuk paraqet propozim për dorëzimin e sendeve, brenda</p>	<p>Član 102 Obustava postupka</p> <p>1. Izvršni organ će obusraviti izvršenje ako nijedna od strana ne podnosi predlog za drugu aukciju, ili za prodaju putem neposrednog dogovora, shodno člana 109.2, odnosno ako poverilac ne podnosi predlog za predaju stvari, u roku predviđenom u članu 109.4 ovog zakona.</p>	<p>Article 102 Suspension of procedure</p> <p>1. The enforcement authority shall suspend the enforcement if none of the parties presents proposal for second auction, or for sale through direct settlement according to Article 109 paragraph 2, respectively if the creditor does not present a proposal for delivery of items, within the deadline</p>

<p>afatit të paraparë në nenin 109.4 të këtij ligji.</p> <p>2. Dispozitat e sipërme të këtij neni zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe për shitjen e sendeve të sekuestruara me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë.</p> <p>Neni 103 Të drejtat dhe detyrimet e blerësit</p> <p>1. Blerësi ka për detyrë ta depozitojë çmimin blerës dhe sendet t'i marrë përsipër menjëherë pas përfundimit të ankandit, apo të shitjes me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë.</p> <p>2. Autoriteti permbarues do t'ia dorëzojë blerësit sendet edhe para se ta ketë depozituar shumën e të hollave në emër të çmimit blerës, në qoftë se për këtë gjë në rrezik të vet e jep pëlqimin kreditori brenda suazave të shumës që do t'i takonte nga çmimi i realizuar i shitjes.</p> <p>3. Në qoftë se blerësi nuk e depoziton shumën e të hollave në emër të çmimit blerës, personat nga paragrafi 2 i këtij neni, mund të kërkojnë nga autoriteti permbarues në të njëjtën procedurë që me aktvendim të urdhërohet blerësi ta bëjë depozitim e saj dhe pasi të bëhet i formës së prerë, të propozohet përmbarimi i sajë.</p>	<p>2 Gornje odredbe ovog člana shodno se primenjuju i za prodaju zaplenjenih stvari putem neposrednog dogovora.</p> <p>Član 103 Prava i obaveze kupca</p> <p>Kupac je obavezan da deponuje kupovnu cenu i da preuzme stvari odmah po okončanju aukcije, ili prodaje putem neposrednog dogovora.</p> <p>2. Izvršni organ će dostaviti kupcu stvari i pre deponovanja iznosa novca na ime kupovne cene, ukoliko za to na svoj rizik daje saglasnost poverilac u okviru iznosa koji bi mu pripao od realizovane prodajne cene.</p> <p>3. Ako kupac ne deponuje iznos novca na ime kupovne cene, lica iz stava 2. ovog člana mogu od izvršnog organa u istoj proceduri tražiti da se rešenjem nalaže kupcu da vrši deponovanje istog i po pravosnažnosti, predložiti njegovo izvršenje.</p>	<p>foreseen by article 109 paragraph 4 of this law.</p> <p>2. Above provisions of this article shall apply appropriately on the sale of sequestrated items through direct settlement.</p> <p>Article 103 Rights and obligations of purchaser</p> <p>The purchaser shall deposit the purchasing price and immediately take over the items after the conclusion of auction, or sale through direct settlement.</p> <p>2. The enforcement authority shall hand over the items to purchaser even before depositing the amount of money in the height of purchasing price, if the creditor gives his consentat his own risk, within amount that would belong to him from the realized sale price.</p> <p>3. If the purchaser does not deposit the amount of money on behalf of purchasing price, the persons from paragraph 2 of this article, may request the enforcement authority in the same procedure to order the purchaser with a decision, to do the deposit, and after it becomes final, to propose its enforcement.</p>
---	---	--

<p>Neni 104 Momenti në të cilin blerësi bëhet pronar</p> <p>1. Në momentin në të cilin blerësi merr sendet e sekuestruara në posedim, ai bëhet edhe pronar i tyre.</p> <p>2. Blerësit të sendeve nuk i takojnë të drejtat në bazë të përgjegjësisë për mungesat fizike dhe juridike që mund t'i kenë ato.</p>	<p>Član 104 Trenutak u kome kupac postaje vlasnik</p> <p>1. U trenutku u kome kupac preuzima zaplenjene stvari u posedu, on postaje njihov vlasnik.</p> <p>2. Kupcu stvari ne pripadaju prava na osnovu odgovornosti o fizičkim i pravnim nedostacima koje one mogu imati.</p>	<p>Article 104 Moment when the purchaser becomes the owner</p> <p>1. At the moment when the purchaser of items takes them in possession, he becomes the owner.</p> <p>2. The purchaser of items, based on responsibility, does not enjoy the right to appeal for physical and legal deficiencies items may have.</p>
<p>Neni 105 Pagimi i kreditorit të përbarimit</p> <p>1. Në qoftë se nga të hollat e fituara me anë të shitjes së sendeve, e realizon kërkesën e tij vetëm një kreditor i përbarimit, atëherë autoriteti përbarues pa caktuar seancë gjyqësore, me anë të aktvendimit urdhëron që nga shuma e të hollave të fituara me anë të shitjes së sendeve, të paguhen me radhë: shpenzimet procedurale, shpenzimet e caktuara në dokumentin ekzekutiv, kamatat deri në ditën e shitjes së sendeve dhe kërkesa kryesore për realizimin e të cilës është filluar procedura përbarimore.</p>	<p>Član 105 Isplata izvršnog poverioca</p> <p>1. Ako iz novca stečenog prodajom stvari, realizuje svoju potražnju samo jedan izvršni poverilac, onda izvršni organ bez sazivanja sudskog ročišta, rešenjem nalaže da se iz iznosa novca stečenog prodajom stvari, isplaćuju po redosledu: troškovi postupka, troškovi određeni u izvršnom dokumentu, kamate do dana prodaje stvari i glavno potraživanje za čiju realizaciju je započet izvršni postupak.</p>	<p>Article 105 Payment of enforcement creditor</p> <p>1. If from the obtained money from the sale of items, only one enforcement creditor settles the claim, the enforcement authority without scheduling a session, through decision shall order the payment of the following from the amount of obtained money from the sale of items, in the following order: procedural costs, certain costs in enforcement document, interests until the day of the sale of items, and main request for settlement of which is initiated the enforcement procedure.</p>

<p>2. Të hollat që teprojnë pas përmbushjes së kërkesës kryesore i dorëzohen debitorit, po qe se për një gjë të tillë nuk ka pengesa.</p> <p>Neni 106 Pagimi kur janë më shumë kreditorë të përmbarimit</p> <p>1. Po qe se në procedurën përmbarimore i realizojnë kërkesat e tyre më tepër kreditorë të përmbarimit, gjegjësisht nëse përpos kreditorit të përmbarimit i realizojnë kërkesat e tyre edhe personat të drejtat e të cilëve shuhen në momentin e shitjes së sendeve të luajtshme, atëherë ata i realizojnë të drejtat e tyre sipas radhës me të cilën e kanë fituar të drejtën e pengut, apo të drejtën tjetër që shuhet në momentin e shitjes për sendet e sekuestruara dhe të shitura.</p> <p>2. Realizimi i kërkesave në mënyrën e caktuar në paragrafin 1 të këtij neni, bëhet vetëm po qe se me ligj për kërkesat e caktuara nuk është paraparë e drejta e realizimit me përparësi.</p>	<p>2. Novac koji ostaje višak nakon namirenja glavnog potraživanja predaje se dužniku, ako za to nema smetnji.</p> <p>Član 106 Isplata kada je više izvršnih poverioca</p> <p>1. Ako u izvršnom postupku realizuju njihova potraživanja više izvršnih poverioca, odnosno ako osim izvršnog poverioca realizuju njihovu potražnju i lica čija se prava gase u trenutku prodaje pokretnih stvari, onda oni realizuju njihova prava po redosledu po kome su stekli založno pravo, ili drugo pravo koje se gasi u trenutku prodaje o zaplenjenim i prodatim stvarima.</p> <p>2. Realizacija potraživanja na način određen u stavu 1. ovog člana, vrši se samo ako zakonom o određenoj potražnji nije predviđeno preče pravo realizacije.</p>	<p>2. The money that remains after the fulfillment of the main request shall be handed over to the enforcement debtor, if here are no obstacles.</p> <p>Article 106 Payment when there are more enforcement creditors</p> <p>1. If in the enforcement procedure, more enforcement creditors settle their requests claims, respectively if except enforcement creditor also other persons, whose rights are abolished in the moment of sale of movable items, settle their claims, then they will settle their claims in order by which they have obtain the right of pledge, or other right which is abolished at the moment of sale of sequestered items.</p> <p>2. Settlement of claims in assigned manner in paragraph 1 of this articleshall be conducted only if the law, for certain claims, has not provided for the right of priority settlement.</p>
<p>Neni 107 Realizimi proporcionalisht i kredive</p> <p>1. Kreditorët e përmbarimit të radhës së</p>	<p>Član 107 Srazmerna realizacija potražnji</p> <p>1. Poverioci izvršenja istog reda koji se iz</p>	<p>Article 107 Proportional settlement of credits</p> <p>1. Enforcement creditors of the same order,</p>

<p>njëjtë të cilët nga shuma e të hollave të fituara me anë të shitjes së sendeve nuk mund të paguhen plotësisht, paguhen përpjesëtimisht me madhësinë e kërkesave të tyre.</p> <p>2. Me rastin e nxjerrjes së aktvendimit për pagimin, autoriteti përbarues do të marrë parasysh vetëm ato kërkesa në bazë të të cilave aktvendimi për përbarimin ose urdheri përbarues ka marrë formë të prerë në ditën e shitjes së sendeve të sekuestruara.</p> <p>3. Shpenzimet e procedurës së përbarimit, shpenzimet e caktuara në dokumentin përbarues dhe kamatat kanë të njëjtën radhë të pagimit, sikurse kërkesa kryesore për të cilën janë të lidhura.</p> <p>4. Të hollat që teprojnë pas përmbushjes së kërkesave i dorëzohen debitorit në procedurën e përbarimit, po qe se për një gjë të tillë nuk ka pengesa juridike.</p> <p>Neni 108 Zbatimi i dispozitave për përbarimin për sendet e paluajtshme</p> <p>Dispozitat e këtij ligji për përbarimin për sendet e paluajtshme që kanë të bëjnë me çështjen se kush nuk mund të jetë</p>	<p>novčanog iznosa dobijenog prodajom stvari ne mogu u potpunosti biti isplaćeni, isplaćuju se srazmerno veličini njihove potražnje.</p> <p>2. Povodom donošenja rešenja o isplati, izvršni organ će uzeti u obzir samo one zahteve na osnovu kojih je rešenje ili nalog o izvršenju postalo pravosnažno na dan prodaje zaplenjenih stvari.</p> <p>3. Troškovi izvršnog postupka, troškovi određeni u izvršnom dokumentu i kamate imaju isti redosled isplate, kao glavni zahtev za koji se povezuju.</p> <p>4. Novac koji ostaje višak nakon namirenja potražnji predaje se dužniku u postupku izvršenja, ukoliko za to nema pravnih smetnji.</p> <p>Član 108 Primena odredbi o izvršenju za nepokretne stvari</p> <p>Odrede ovog zakona o izvršenju o nepokretnim stvarima koje se odnose na pitanje ko ne može biti kupac, zatim one</p>	<p>who from the amount of obtained money from the sale of items, cannot be paid completely, are paid proportionally with the extent of their requests.</p> <p>2. During the issuance of the decision on payment, the enforcement authority shall take into consideration only the claims based on which the enforcement decision or enforcement writ has become final at the day of the sale of the sequestered items.</p> <p>3. Costs of the enforcement procedure, costs assigned in the enforcement document and interests have the same order of payment, as the main relevant claim.</p> <p>4. The money that remains after the fulfillment of the claims shall be handed over to the debtor in enforcement procedure, if there are no legal obstacles.</p> <p>Article 108 Application of the provisions for enforcement on immovable items</p> <p>Provisions of this law for enforcement on immovable items related to who cannot be a purchaser, provisions related to disputing</p>
---	---	---

<p>blerës, mandej ato që kanë të bëjnë me çështjen e kontestimit të kredive, me udhëzimin për në procedurë kontestimore, si dhe me aktvendimin për përmbushjen e detyrimeve të debitorit në procedurën përmbarimore, zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe në pikëpamje të përmbarimit për sendet e luajtshme me qëllim të realizimit të kredive në të holla.</p>	<p>koje se odnose na pitanje osporavanja potražnji, uputstvom o parničnom postupku, kao i rešenjem o ispunjavanju dužničkih obaveza u izvršnom postupku, shodno se primenjuju i u pogledu izvršenja za pokretne stvari, u cilju realizacije novčane potražnje.</p>	<p>the credits, instruction to contested procedure, and the decision for fulfillment of debtor's obligation in enforcement procedure, shall apply accordingly at enforcement of movable items for the purpose of settlement of monetary credits.</p>
<p>KREU 2 PËRMBARIMI PËR KREDITË E DEBITORIT</p>	<p>GLAVA 2 IZVRŠENJE POTRAŽNJI DUŽNIKA</p>	<p>TITLE 2 ENFORCEMENT FOR DEBTOR'S CREDITS</p>
<p>Neni 109 Kompetenca territoriale ne rastet e permbarimit gjyqesor</p>	<p>Član 109 Mesna nadležnost u slučajevima sudskog izvršenja</p>	<p>Article 109 Territorial jurisdiction in case of court enforcement</p>
<p>1. Vendosja për propozimin për përmbarimin lidhur me kredinë në të holla të debitorit dhe për aplikimin e këtij lloji të përmbarimit, kompetencë territoriale ka gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi i debitorit. Në qoftë se debitori nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë është kompetente gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendqëndrimi i debitorit.</p> <p>2. Në qoftë se debitori nuk ka në Kosovë as vendbanim e as vendqëndrim, kompetencë ka gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi i debitorit të debitorit në procedurën përmbarimore. Në</p>	<p>1. Za rešavanje o predlogu za izvršenje u vezi sa novčanom potražnjom dužnika, mesno nadležan je sud na čijem se području nalazi mesto stanovanja dužnika. Ako dužnik nema mesto stanovanja na Kosovu, onda nadležan je sud na čijem se području nalazi mesto boravka dužnika.</p> <p>2. Ako dužnik nema mesto stanovanja niti boravka na Kosovu, nadležan je sud na čijem se području nalazi mesto stanovanja dužnikovog dužnika u izvršnom postupku. Ako dužnikov dužnik nema mesto</p>	<p>1. To decide on proposal for enforcement for monetary credits of debtor and for application of such type of enforcement, territorial jurisdiction is with the court where the residence of debtor is located. If debtor does not have residence in Kosovo, territorial jurisdiction is with the court competent for the territory where debtor stays.</p> <p>2. If debtor does not have a residence nor a place of stay in Kosovo, territorial jurisdiction is with the court in territory where residence of debtor's debtor in enforcement procedure is located. If</p>

<p>qoftë se debitori i debitorit nuk ka në Kosovë vendbanim, atëherë është kompetente gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendqëndrimi i debitorit të debitorit.</p> <p>3. Për personat juridik kompetente territorial është gjykata ku gjendet selia e personit juridik ose selia e njësisë organizative të tij, si dhe gjykata në territorin që ka nxjerrë dokumentin përmbarues.</p> <p>4. Vendosja për propozimin për përmbarimin lidhur me kredinë në të holla të debitorit dhe për aplikimin e këtij lloji të përmbarimit, përmbaruesi privat ka kompetencë territoriale për të vendosur mbi propozimin përmbarimor dhe të zbatojë përmbarimin.</p> <p>Neni 110 Kompetenca territoriale në rast të ushqimit ligjor</p> <p>Përjashtimisht nga neni 118 i këtij ligji, kreditori i përmbarimit të kredisë për ushqimin ligjor, ka të drejtë që propozimin e tij ta paraqesë në gjykatën në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi apo vendqëndrimi i tij.</p>	<p>stanovanja na Kosovu, onda je nadležan sud na čijem se području nalazi boravoravište dužnikovog dužnika.</p> <p>3. Za pravna lica mesno nadležan je sud gde se nalazi sedište pravnog lica ili sedište njegove organizacione jedinice, kao i sud na čijem je području pribavljen izvršni dokument.</p> <p>4. Odlučivanje o predlogu za izvršenje u vezi novčane potražnje dužnika i za primenu ove vrste izvršenja, privatni izvršitelj je mesno nadležan da odlučuje o izvršnom predlogu i o sprovođenju izvršenja.</p> <p>Član 110 Mesna nadležnost u slučaju zakonskog izdržavanja</p> <p>Izuzetno od člana 118. ovog zakona, izvršni poverilac potraživanja za zakonsko izdržavanje, ima pravo da njegov predlog podnosi sudu na čijem se području nalazi njegovo mesto stanovanja ili boravka.</p>	<p>debtor's debtor does not have a residence or a place of stay in Kosovo, territorial jurisdiction is with the court in territory of which is place of stay of debtor's debtor.</p> <p>3. For legal persons territorial competence is with the court where the seat of legal person is located or the seat of its organizational unit, also the court competent over the territory where the enforcement document is issued.</p> <p>4. Private enforcement agent shall have the territorial jurisdiction to decide on enforcement proposal and carry out the enforcement on monetary credit of debtor.</p> <p>Article 110 Territorial jurisdiction in case of court enforcement in case of legal nutrition</p> <p>Exceptionally from article 118 of this law, enforcement creditor of credit for legal nutrition, has the right to present his proposal to the court in territory of which is his residence or place of stay.</p>
--	--	--

<p>Neni 111 Përrjashtimi nga përmbarimi</p> <p>1. Përrjashtohen nga përmbarimi të ardhurave nga ushqimi ligjor, po qe se nuk kemi të bëjmë me kreditë e llojit të njëjtë.</p> <p>2. Objekt përmbarimi nuk mund të bëhen kreditë në bazë të tatimeve dhe të kontributeve të caktuara me anë të ligjit.</p>	<p>Član 111 Izuzimanje od izvršenja</p> <p>1. Izuzimaju se od izvršenja prihodi zakonskog izdržavanja, ako se ne radi o potražnjima iste vrste.</p> <p>2. Predmet izvršenja ne mogu postati potraživanja na osnovu poreza i doprinosa određenih zakonom.</p>	<p>Article 111 Exclusion from enforcement</p> <p>1. Incomes from the legal nutrition are excluded the from enforcement, if not related to the credits of the same type.</p> <p>2. The object of enforcement cannot be the credits based on taxes and contributions assignedby the law.</p>
<p>Neni 112 Kufizimi i përmbarimit</p> <p>1. Përmbarimi në të ardhurat personale, për shpërblimin në vend të pagës dhe për pensionin, mund të caktohet dhe zbatohet deri në gjysmën e lartësisë së tyre. Shuma që sekuestrohet do të kufizohet në pjesën që tejkalon shumën e ndihmës më të lartë sociale që paguhet brenda territorit ku debitori ka vendbanimin.</p> <p>2. Përmbarimi për fitimin e garantuar i cili i takon debitorit në procedurën e përmbarimit, në bazë të kontratës kolektive dhe ligjit, mund të caktohet dhe zbatohet vetëm deri në një të tretën e sasisë së tij.</p> <p>3. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni</p>	<p>Član 112 Ograničenje izvršenja</p> <p>1. Izvršenje na lični dohodak, za nadoknadu umesto plate i za penziju, može se odrediti i primeniti do polovine njihove visine. Zapljenjeni iznos će se ograničiti na deo koji prevazilazi iznos najveće socijalne pomoći koja si isplaćuje unutar teritorije gde je dužnikovo prebivalište.</p> <p>2. Izvršenje garantovane dobiti, koja pripada dužniku u izvršnom postupku, shodno kolektivnom ugovoru i zakonu, može se odrediti i sprovoditi samo do jedne trećine tog iznosa.</p> <p>3. Odredbe stava 2. ovog člana primenjuju</p>	<p>Article 112 Limitation of enforcement</p> <p>1. Enforcement against personal incomes, on reward instead of salary and on pensions, may be assigned and applied up to the half of their amount. The amount to be sequestrated shall be limited in the part that exceeds the amount of social benefit paid in the territory where the debtor lives.</p> <p>2. Enforcement for guaranteed profit which belongs to debtor in enforcement procedure, based on collective contract and law, may be assigned and applied up to the one third of its quantity.</p> <p>3. Provisions of paragraph 2 of this article</p>

<p>zbatohen edhe në rast të përmbarimit për të ardhurat në bazë të shpërblimit për shkak të dëmtimit të trupit sipas dispozitave për sigurimin invalidor, për të ardhurat në bazë të ndihmës sociale, për të ardhurat në bazë papunësisë së përkohshme, për të ardhurat në bazë të shtesave për fëmijë, për të ardhurat në bazë të bursës studentore dhe ndihmës studentëve dhe nxënësve, si dhe për të ardhurat nga puna e personave të dënuar me burgim.</p> <p>4. Përmbarimi për të ardhurat në bazë të kontratës për ushqimin e përhershëm dhe për rentën e përhershme, si dhe për të ardhurat në bazë të kontratës për sigurimin e jetës, mund të zbatohet vetëm në atë pjesë që e tejkalon shumën e ndihmës më të lartë të përhershme sociale që paguhet në territorin ku debitori ka vendbanimin e vet.</p> <p>5. Përmbarimi për të ardhurat e invalidëve të luftës, dhe ato në bazë të shtesës invalidore, mund të zbatohet vetëm për përbushjen e kredive në bazë të ushqimit ligjor, shpërblimit të dëmit të krijuar për shkak të humbjes së aftësisë për punë dhe shpërblimit të dëmit për humbjen e ushqimit për shkak të vdekjes së dhënësit të ushqimit, deri në shumën e gjysmës së këtyre të ardhurave.</p>	<p>se i u slučaju izvršenja na prihod po osnovu nadoknade za telesno oštećenje shodno odredbi o invalidskom osiguranju, na prihod po osnovu socijalne pomoći, na prihod po osnovu privremene nezaposlenosti, na prihod po osnovu dečjeg dodatka, na prihod po osnovu studentske stipendije i pomoći studenata i učenika, kao i na prihod po osnovu rada lica kažnjenih zatvorom.</p> <p>4. Izvršenje na prihod po osnovu ugovora o doživotnom izdržavanju i doživotnoj renti, kao i na prihod po osnovu ugovora o osiguranju života, može se sprovoditi samo u tom delu koji prevazilazi iznos najviše trajne socijalne pomoći koja se isplaćuje na području gde je mesto stanovanja dužnika.</p> <p>5. Izvršenje na prihod invalida rata i na prihod po osnovu invalidskog dodatka, može se sprovoditi samo za namirenje potraživanja po osnovu zakonskog izdržavanja, nadoknade štete nastale zbog gubljenja radne sposobnosti i nadoknade zbog gubljenja izdržavanja zbog smrti davaoca izdržavanja, do polovine iznosa ovih prihoda.</p>	<p>shall also apply in the case of enforcement against the incomes based on rewards, due to bodily damage according to the provisions of disability guarantee, incomes based on social assistance, incomes based on temporary unemployment, incomes based on children's allowances, incomes based on student's scholarship and assistance to students and pupils, and incomes from work of the persons convicted to imprisonment.</p> <p>4. Enforcement against incomes based on the contract for life nutrition of and for life rent, and also incomes based on the contract for life guarantee, may apply only in a part which exceeds the amount of the highest permanent social assistance which is paid in the territory where debtor has his residence.</p> <p>5. Enforcement against the incomes of the war invalids, and the ones provided with invalidity allowances, may apply only for fulfillment of the credits based on legal nutrition, compensation for caused damage due to the loss of working ability and reward for damage due to loss of nutrition because of the death of nutrition provider, up to amount of half of these incomes.</p>
---	--	--

<p>Neni 113 Veprimet përmbarese</p> <p>1. Përmbarimi për kredinë në të holla të debitorit në procedurën përmbarimore zbatohet me anë të sekuestrimit dhe kalimit (transferimit) të tij/saj, po qe se me këtë ligj për rastet e veçanta nuk është paraparë ndryshe.</p> <p>2. Me anë të propozimit për përmbarim, mund t'i propozohet gjykatës që ta caktoj vetëm sekuestrimin e kredisë në të holla të debitorit, por në këtë rast kreditori i përmbarimit ka për detyrë që brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita kur i është dorëzuar aktvendimi për sekuestrim, respektivisht nga dita kur i është dorëzuar njoftimi për deklarimin e debitorit të debitorit, apo për mosdeklarimin e tij brenda afatit të caktuar, të paraqesë propozimin për kalimin (transferin) e kredisë.</p> <p>3. Në qoftë se kreditori i përmbarimit brenda afatit të paragrafit 2 të këtij neni, nuk e paraqet propozimin për kalimin e kredisë së debitorit, procedura e përmbarimit do të pezullohet.</p>	<p>Član 113 Izvršne radnje</p> <p>1. Izvršenje na novčanu potražnju dužnika u izvršnom postupku sprovodi se zaplenom i njenim transferom (prenošenjem), ako po ovom zakonu za posebne slučajeve nije predviđeno drugačije.</p> <p>2. Predlogom o izvršenju može se predložiti sudu da odredi samo zaplenu novčanog potraživanja dužnika, ali u tom slučaju izvršni poverilac je obavezan da, u roku od 30 dana, od dana kada mu je uručena odluka o zaplenjivanju, odnosno od dana kada mu je uručeno obaveštenje o izjašnjanju dužnikovog dužnika, ili o njegovom ne izjašnjanju u okviru određenog roka, podnese predlog za prenos (transfer) potražnje.</p> <p>3. Ako izvršni poverilac u roku iz stava 2. ovog člana ne podnese predlog za prenos potraživanja dužnika, izvršni postupak će biti obustavljen.</p>	<p>Article 113 Enforcement actions</p> <p>Enforcement against monetary credits of the debtor in enforcement procedure shall apply through its sequestration and transfer, if this law, for special cases, does not provide otherwise.</p> <p>2. Through the proposal for enforcement, may be proposed to the enforcement authority to assign only sequestration of debtor's monetary credit, but in this case the enforcement creditor has duty within 30 from the day when the decision on sequestration is delivered to him, respectively from the day when the notification for declaration of debtor's debtor, or his non-declaration within assigned deadline, to present the proposal for transfer of credit.</p> <p>3. If enforcement creditor within time-limit from paragraph 2 of this article does not present proposal for transfer of debtor's credit, the enforcement procedure will be suspended.</p>
<p>Neni 114 Vëllimi i përmbarimit</p>	<p>Član 114 Obim izvršenja</p>	<p>Article 114 Extent of enforcement</p>

<p>1. Sekuestrimi dhe kalimi i kredisë në të holla, mund të caktohen vetëm në shumën që nevojitet për realizimin e kredisë së kreditorit të përbarimit, përveç në qoftë se është fjala për kredinë e papjesëtueshme.</p> <p>2. Në qoftë se më tepër kreditorë të përbarimit e kërkojnë përbarimin për të njëjtën kredi të debitorit që është e ndashme, sekuestrimi dhe kalimi caktohen në shumat përkatëse veç e veç në dobi të secilit propozues.</p>	<p>1. Zaplena i prenos novçane potražnje, mogu se odrediti samo u iznosu koji je potreban za realizaciju potraživanja izvršnog poverioca, osim ako se radi o nedeljivoj potražnji.</p> <p>2. Ako više izvršnih poverioca traže izvršenje za istu potražnju dužnika koja je deljiva, zaplena i prenos se određuju u odgovarajućim iznosima ponaosob u korist svakog od predlagača.</p>	<p>1. Sequestration and transfer of monetary credit may be assigned only on the amount needed for settlement of the credit of enforcement creditor, unless it is concerned indivisible credit.</p> <p>2. If more enforcement creditors claim the enforcement for the same debtor's credit which is divisible, sequestration and transfer shall be assigned in respective separate amounts in benefit of each proposer.</p>
<p>Neni 115 Sekuestrimi i kredisë së debitorit</p>	<p>Član 115 Zaplena potraživanja dužnika</p>	<p>Article 115 Sequestration of debtor's credit</p>
<p>1. Me aktvendimin me të cilin caktohet sekuestrimi i kredisë në të holla të debitorit, i ndalohet debitorit të debitorit që t'ia paguajë borxhin debitorit të përbarimit, kurse këtij të fundit i ndalohet që kredinë e këtillë ta realizojë, apo që me të të disponojë në ndonjë mënyrë tjetër.</p> <p>2. Ndalimi e përfshinë edhe disponimin me pengun e kontraktuar për sigurimin e kredisë së sekuestruar.</p>	<p>1. Rešenjem kojim se određuje zaplena novčane potražnje dužnika, zabranjuje se dužnikovom izvršnom dužniku da izvršnom dužniku isplati dug dužniku izvršenja, ili da istim na neki drugi način raspolaže.</p> <p>2. Zabrana uključuje i raspolaganje ugovorenim zalogom za osiguranje zaplenjene potražnje.</p>	<p>1. With the decision assigning the sequestration of credit's monetary credit, the debtor's debtor shall be prohibited to pay to enforcement debtor the debt, while the latter is prohibited to settle such credit, or to dispose with it in some other way.</p> <p>2. Prohibition includes also the disposal of pledge contracted for guarantee of the sequestrated credit.</p>
<p>Neni 116 Efekti i sekuestrimit të kredisë</p>	<p>Član 116 Dejstvo zaplenjivanja potražnje</p>	<p>Article 116 The effect of sequestration of credit</p>
<p>1. Sekuestrimi i kredisë në të holla të</p>	<p>Zaplenjivanje novčanog potraživanja</p>	<p>1. Sequestration of debtor's monetary</p>

<p>debitorit quhet i kryer në ditën në të cilën debitorit të debitorit i është dorëzuar aktvendimi për sekuestrimin.</p> <p>2. Kreditori i përbarimit me anë të sekuestrimit të kryer e fiton të drejtën e pengut për kredinë e debitorit të përbarimit.</p> <p>3. Debitori i debitorit nuk ka as të drejtë prapësimi, e as të drejtë ankimi kundër aktvendimit për sekuestrimin e kredisë së kreditorit të tij.</p>	<p>duznika smatra se izvršenim na dan kada je dužnikovom dužniku uručeno rešenje o zaplenjivanju.</p> <p>2. Izvršni poverilac putem izvršene zaplene stiče založno pravo na potražnji dužnika izvršenja.</p> <p>3. Dužnikov dužnik nema niti pravo prigovora, niti pravo žalbe protiv rešenja o zapleni potraživanja njegovog poverioca.</p>	<p>credit is considered finished at the day when the decision on sequestration is delivered to the debtor's debtor.</p> <p>2. Enforcement creditor through completed sequestration gains the right of pledge for the credit of enforcement debtor.</p> <p>3. Debtor's debtor does not have a right to object or to appeal against the decision on sequestration of his creditor's credit.</p>
<p>Neni 117 Sekuestrimi i kredisë së bazuar në letrën me vlerë</p>	<p>Član 117 Zaplenjivanje potraživanja baziranog na hartiju od vrednosti</p>	<p>Article 117 Sequestration of credit based on securities</p>
